

Pronësia e medias në 2022

Shkup, 17 qershor 2022 – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale përgatiti publikimin për pronësinë e medias në vitin 2022, për sigurimin e një transparence më të madhe për pronësinë e medias, duke shfrytëzuar të dhëna zyrtare mbi strukturën e pronësisë së transmetuesve nga Regjistri Qendror i RS Maqedonisë, për botuesit e medias së shkruar dhe të dhëna nga shpalljet në gazetën ditore (përditëshme) të cilat i kryenin në kuadër të përmbushjes së detyrimit ligjor për të ofruar transparencë të punës.

Në këtë publikim, i katërti me radhë i këtij lloji, në pjesë të veçanta janë paraqitur të dhëna për pronarët e televizioneve dhe radiostacioneve, si dhe botuesit e medias së shkruar në vitin 2022.